



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 22.10.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E SHQIPËRISË) – SKJE (MALI I ZI) PËR QARKULLIMIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS”

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22 tetor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Jurgis Çyrbja. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të sjellë lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonave afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të Malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit, shkurtimin e distancës, i cili ndikon gjatë sezonit turistik në uljen e fluksit të hyrjeve dhe daljeve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Muriqan, kontrollin më të mirë të sektorit të kufirit në zonën e Zogaj dhe veçanërisht kontrollin e bregut të liqenit të Shkodrës, si dhe shfrytëzimin e vlerave turistike të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORI

Jurgis ÇYRBJA

KRYETARI

Ulsi MANJA